



P Z A P  
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.469/2025

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesuese, Kymete Kicaj e Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës ,në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.02.2025, merr këtë:

### V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.469/2025, të datës 09.02.2025, e paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

### A r s y e t i m

Me datën 09.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër A.nr.469/2025 , të datës 09.02.2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV). me seli në Prishtinë, në të cilat pretendohet se më datë 8 shkurt 2025, Qendra e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka identifikuar statusin e kryetarit të Prishtinës nga rradhët e subjektit politik LDK, Perparim Rama që ka berë thirje duke shkruar “DIASPOR E DASHUR”. Të nderuar qytetarë të respektuar bashkëkombës, Sot, më shumë se kurrë, është e rëndësishme të rikthejmë vlerat mbi të cilat është ndërtuar shteti ynë: Respektin për sakrificën e atyre që luftuan păr lirinë tonë - JO ofendime dhe mohime të sakrificës së tyre! Ata që dhanë jetën dhe u flijuan për këtë vend meritojnë nderim dhe mirënjojje të përjetshme, jo fyerje dhe urrejtje. Respektin ndaj atyre që ndërtuan institucionet e këtij shteti - JO përqeshie dhe nxiti të përçarjes! Kosova nuk u ngrit nga askund por mbi mundin, dijen dhe vizionin e atyre që ndërtuan themellet e saj, dhe askush nuk ka të drejtë t'i përbaltë këto arritje. Forcimin e familjes si shtylla themelore e shoqërisë sonë dhe mbrojtjen e individualitetit si vlerë e patjetërsueshme -

JO imponim ideologjik dhe propagandë totalitare! Kosova është dhe duhet të mbetet një vend i lirë, ku qytetarët nuk uniformohen, nuk ndjekin verbërisht individin dhe nuk bien pre e politikave që kërkojnë nënshtrim e jo mendim të lirë. JO bereta të kuqe, JO "Baba"! Të besojmë në një Kosovë të ndërtuar mbi vlera të qëndrueshme, mbi respekt dhe dinjitet, jo mbi përçarje, mohim e manipulim! Nuk kemi ardhur këtu për të ndarë njerëzit, për të përçarë qytetarët apo për të përdorur gjuhën e urrejtjes dhe fyerjeve. Nuk duhet të jetë Politika si një arenë hakmarrjeje, por si një mision për të ndërtuar një të ardhme më të mirë păr të' gjithë, Fatkeqësisht, ata që sot e mbajnë pushtetin e kanë dëshmuar të kundërtën, pa një program për qytetarët, vetëm përçarje, përqeshje etiketime dhe ofendime. Ata nuk kanë ndërtuar, por kanë bllokuar! Projektet madhore të kryeqytetit dhe të shumë komunave të tjera janë bllokuar nga qeveria, jo për arsy profesionale apo ligjore, por për inate politike. Në vend që të punonin păr zhvillim, ata kanë penalizuar qytetarët, duke i ndaluar investimet që do të përmirësonin jetën e secilit prej jush. Kemi humbur projekte të mëdha për shkak të paaftësisë dhe izolimit që kjo qeveri i ka shkaktuar Kosovës në arenën ndërkombëtare. Nuk ka asnë dyshim: marrëdhëni tonë me miqtë tanë, me ata që gjithmonë na kanë mbështetur, janë dëmtuar rëndë. Për herë të parë në historinë e Kosovës, asnë zyrtar i kësaj qeverie nuk është ftuar e as takuar nga partneri ynë më i madh strategjik - Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo është e papranueshme! Kjo është një goditje e rëndë për shtetin dhe qytetarët tanë, për të ardhmen tonë. Shteti nuk mund të ecë përpara me njerëz që nuk dinë të udhëheqin, që nuk kanë vizion dhe që e shohin politikën si një lojë hakmarrjeje. Këtë popull nuk duhet ta mbajmë nën frikën e armikut të jashtëm e të brendshëm! Duhet të rikthejmë besimin, të hapim rrugën për zhvillim dhe të forcojmë themelat e një shteti që respekton sakrificën e së kaluarës dhe ndërton një të ardhme të sigurt për të gjithë. Prishtina po ecë para me realizim rekord të buxhetit, me vizion e mision, përkunder sfidave. T'i ndihmojmë edhe Kosovës nesër me votën tuaj të çmuar. Me tutje ne ankes theksojn se kryetari i Prishtines nga radhët e LDK, me këto veprime ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1, nen parografi 1.11 te LZP-së, në Republikën e Kosovës. Si provë ankesës ja ka bashkangjitur linkun e postimit në facebook.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), theksohet se, pretendimet ankimore të ankuesit dhe provat e bashkangjitura të ankesave me pretendimin se Kryetari në fjal se ka bërë shkelje, në asnë rrethanë ligjerisht nuk qendron, me tutje theksojn se nuk ka të bëjë measnë formë të gjuhës nxitëse, provokuese që mund të dërgon në akt dhune kundër personave tjera apo pasuris, dhe se i njëjti u është drejtuar qytetarëve të Prishtines, dhe se heshtja zgjedhore ka vlejtur më 9 shkurt nga ora 07:00 deri në ora 19:00. Poashtu në përgjigje në ankesë theksojn se perdonimi i fjalëve të tillë në postime publike është pjesë e normave të diskursit politik dhe është i nevojshëm për tu vlersuar dhe analizuar qëndrimet e garuesve dhe opinonet e tyre në politikë ashtu që në menyrë të drejtë dhe pa qëllime të tjera, andaj nëse analizohet fjalë përfjalë postimi i kryetarit në fjalë në asnijëren nga to nuk ka të bëjë me gjuhë provokuese, nxitëse apo urrejtje. Kërkojnë nga PZAP-i, që të refuzohet ankesa në fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

**-Ankesa është e pabazuar**

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës dhe provave materiale të bashkangjitura, ka gjetur se kryetari Perparim Rama ka shpërndarë një postim në rrjetin social Facebook, me tekst shoqëruesh, në të cilën ka dekluarar "Diaspor e Dashur". Sot, më shumë se kurrë, është e rëndësishme të rikthejmë vlerat mbi të cilat është ndërtuar shteti ynë: Respektin për sakrificën e atyre që luftuan për lirinë tonë - JO ofendime dhe mohime të sakrificës së tyre!, Paneli vlerësoi se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me asnje formë të gjuhës së urejtjes, nxitjes, apo provokuese sepse i njëjti ka bërë thirje qytetarve të Prishtines, për të votuar, andaj nuk mund të konsiderohet se është në kundërshtim me nenin 34 pika I, nenoarografi 1.11, e LZP-së, në të cilin nen në mënyrë shprehimore thuhet se: "*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografji, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*".

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik LDK, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj përfaktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: "*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi si në vijim: përdorimi i gjuhës, nëformën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografji, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*".

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik ankues, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, përfaktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që kryetari Perparim Rama ka shpërndarë një postim në rrjetin social Facebook, me tekst shoqëruesh, në të cilën ka dekluarar "Diaspor e Dashur. Sot, më shumë se kurrë, është e rëndësishme të rikthejmë vlerat mbi të cilat është ndërtuar shteti ynë: Respektin për sakrificën e atyre që luftuan për lirinë tonë - JO ofendime dhe mohime të sakrificës së tyre", që sipas vlerësimit të Panelit është në përputhje me diskursin e fushatës zgjedhore dhe i njëjti nuk ka fyter, degraduar apo nxitje të urejtjes ndaj subjektit politik Vetëvendosje dhe nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore.

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar përfaktin se cilën referohet pala ankuese. Andaj duke u mbështetur në nenin 1 17.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, përfaktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lart.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 pa. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A.nr.469/2025 më datën 11.02.2025



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.